



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 22.10.2019, ora 17.30

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës:

Shpallja e fillimit të procedurës së verifikimit të kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr.11291 datë 27.09.2019, si edhe zhvillimi i procedurës së shortit për përcaktimin e anëtarit relator të KED për ndjekjen e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të këtij vendi vakant.

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|-----------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Arta Marku | (anëtare) |
| 3. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 5. Fatjona Memçaj | (anëtare) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, përfaqësues i Avokatit të Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se në mbledhje mungojnë zëvendëskryetarja e Këshillit, znj. Vitore Tusha, si edhe anëtari Eril Roshi, për arsye të angazhimeve përkatëse zyrtare jashtë Shqipërisë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Shpallja e fillimit të procedurës së verifikimit të kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr.11291 datë 27.09.2019, si edhe zhvillimi i procedurës së shortit për përcaktimin e anëtarit relator të KED për ndjekjen e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të këtij vendi vakant.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen më çështjen e caktuar në rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se siç jeni në dijeni, me vendimin nr.137, date 21.09.2019, Këshilli ka vendosur të pezullojë procedurën e verifikimit për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe të njoftojë Presidentin e Republikës për rivlerësimin e rishpalljes së thirrjes për aplikim në këtë vend vakant. Presidenti i Republikës e ka shpallur procedurën e aplikimit për plotësimin e këtij vendi vakant dhe afati mbaronte ditën e premte. Pasi u ezauruan të gjitha afatet dhe Presidenca ka bërë kujdes që të mundësonte shprehjen e interesit edhe në rastet e dërgimit më postë. Pasi përfunduan të gjitha afatet, ditën e sotme

është shpallur lista e kandidatëve, të cilët kanë shprehur interesin për kandidim për këtë vend vakant. Dokumentacioni ka ardhur dhe është depozituar i plotë dhe është marrë në dorëzim me procesverbal si çdo rast tjetër. Për të verifikuar paraprakisht çështje të konfliktit të interesit, nëse ka, tre nga kandidatët janë të kandiduar edhe në vendin tjetër vakant të shpallur nga Kuvendi: Vjosa Bodo, Dede Kasnesi, Shaqir Hasani. Janë tre kandidatë të tjerë që kandidojnë në këtë vend vakant, të cilët janë: Prel Martini, Envi Hicka dhe Vasil Bendo, të cilët duhet t'i bashkëngjiten në këtë procedurë gare znj.Regleta Panajoti, e cila është një kandidate e lejuar për këtë vend vakant.

Do të sugjeroja që mund të marrim së pari vendimin për ta revokuar vendimin nr.137, datë 21.09.2019 për pezullimin e procedurës së verifikimit dhe vlerësimit për këtë vend vakant dhe, pas kësaj, nëse do të jeni dakord, mund të kalojmë në një diskutim të shkurtër, nëse do të kemi nevojë të kemi short për relatorin në këtë rast, nëse po të hedhim shortin për relatorin, nëse jo të vijojmë me shortin për të ndarë mes tre këshilltarëve, tre kandidatët, të cilët nuk janë në proces verifikimi ndryshe nga të tjerët.

Anëtarët e Këshillit shprehen dakord me këtë mënyrë procedimi të mbledhjes.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se nuk e di nëse ka ndonjë kundërshtim, por unë nuk shikoj asnjë arsye që të mos e revokojmë vendimin nr.137, datë 21.09.2019 të këtij Këshilli për pezullimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave, të cilin e kemi përpara. Është i njëjti tekst projektakti që kemi bërë dhe në një rast tjetër vendi vakant. Përveç revokimit të pezullimit, pika e dytë pastaj është ajo për vijimi i procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave për këtë vend vakant të rishpallur me dekretin e Presidentit të Republikës nr.11291 datë 27.09.2019 Jemi dakord?

Anëtarët e Këshillit në mënyrë unanime vendosin revokimin e vendimit nr. 137 datë 21.09.2019 të KED dhe vijimin e procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave për këtë vend vakant të rishpallur me dekretin e Presidentit të Republikës nr.11291 datë 27.09.2019.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe orienton se për pjesën e dytë të pikës së rendit të ditës, lidhur me shortin, situata është e tillë. Tani kemi një kandidat në garë, e cila është lejuar, është znj.Regleta Panajoti. Kishim edhe z.Besnik Muçin kandidat në garë sepse kishim ngelur me dy kandidatë. Por ai ka marrë emërimin por dhe ka kryer dhe betimin. Kështu që tani e kemi një kandidat në garë. Mendoni se duhet të bëjmë short për relatorin sepse kjo është një vakancë, e cila ishte nën kujdesin e relatorit z.Roshi, apo duhet që me revokimin e vendimit të pezullimit dhe me vijimin e procedurës të vazhdoi i njëjti relator, pra të veprojmë njësoj sikurse vepruam me rastin e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe në mënyrë unanime vendosin që të vijojë i njëjti relator, edhe për shkakun se sipas nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 anëtari relator caktohet për vakancën dhe jo për kandidatët.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe orienton diskutimin për mënyrën e caktimit me short të këshilltarëve të Gjykatës së Lartë të destinuar për të punuar me Këshillin nisur nga rrethat konkrete të ecures së procedurës në këtë vakancë dhe kandidatëve konkretë që janë kandiduar aty. Janë vetëm tre nga kandidatët të rinj sepse zonja Bodo, z.Kasneci dhe z.Hasanaj janë kandidatë edhe në vakancën tjetër. Çështja mund të jetë atë hedhim në short ndarjen e të gjashtë kandidatëve për tre këshilltarët apo vetëm tre kandidatët e rinj duke i caktuar me short një kandidat secilit këshilltar.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe në mënyrë unanime vendosin që të caktohen me këshilltarët që punojnë me anëtarin relator për të gjashtë kandidatët, duke i caktuar secilit këshilltar me short nga dy kandidatë.

MBYLLET PJESA E PARË E MBLEDHJES

Në pjesën e dytë të mbledhjes, duke filluar nga ora 17.15, realizohen veprimet e shortit për caktimin e këshilltarëve që punojnë secili me aktet për dy kandidatë në mbështetje të veprimtarisë së anëtarit të Këshillit relator i vakancës.

Procesverbali i hedhjes së shortit i bashkëlidhet këtij procesverbalit të mbledhjes së Këshillit.

PJESA E TRETË E MBLEDHJES

Ardian Dvorani, pas përfundimit të procedurës së shortit, informon anëtarët se në lidhje me vendet vakante në proces, janë shpërndarë të gjithë kërkesat për informacion në institucione. KED tani e ka përvojën, jemi të organizuar më mirë për mos u vonuar me procesin, nuk do të jetë ngarkesa e herëve të para sepse me kalimin e kohës jemi mësuar ti sistemojmë çështjet. Po vijnë edhe shumë nga përgjigjet, p.sh nga institucionet financiare më shumë se gjysma janë sjellë që tani dhe po vijnë me shpejtësi për të gjithë kandidatët. Edhe kandidatët për ILD i kanë dorëzuar deklaratat e pasurisë etj. në afat. Kështu që nuk do të ketë humbje kandidatësh për shkak të afatit. Në këtë rast po njoftojmë ILDKPKI sepse kemi një situatë që tre nga kandidatët sapo e kanë dorëzuar deklaratën e pasurisë prej rreth dy javësh për procedurën e vakancën tjetër ku kandidohen gjithashtu. Pritet që ILDKPKI të konfirmojë nëse do ta plotësojnë edhe njëherë deklaratën e pasurisë nga e para apo jo. Po kështu është

vepruar edhe me kërkesat për informacion në organet ligjzbatuese lidhur me kushtet ligjore të integritetit duke qenë se po këta kandidatë janë në verifikim prej tyre për shkak të kandidimit në vakancën tjetër. Edhe në lidhje me ecurinë disiplinore etj., janë dëgjuar qysh tani kërkesat për informacion nëpër institucione sipas rastit e në varësi të profilit profesional të kandidatit. Ndaj në dhjetor mund të përfundohet dhe të dërgohen listat organit të emërtesës. KED ka vullnetin dhe angazhimin për ta bërë procesin më shpejt por gjithçka do të varet nga përgjigjet e institucioneve.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës dhe deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 18.05

Sekretare

Dorina Dulaj

Ermelinda Kadiu

Kryetari

Ardian Dvorani